


# Curriculum Vitae

Erarba Çiraku

 +355 686488983

 erarba\_ciraku@yahoo.com



## SHKOLLIMI DHE KUALIFIKIMET

2015

**Doktor** i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare

Tema: Emigracioni shqiptar në Itali, sfidat sociale, ekonomike e politike.

2003 – 2004

**Master:** “Politikat socio-ekonomike për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit”.

Universiteti i Bolonjës, Bolonjë (Itali)

- Planifikimi strategjik i territorit, procesi i planifikimit strategjik për një zhvillim lokal të qëndrueshëm.
- Shoqëritë multikulturore dhe zhvillimi lokal. Procesi i decentralizimit dhe pjesëmarrjes.
- Sociologjia e zhvillimit, teoritë e zhvillimit lokal.
- Organizimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme.
- Metodologjia dhe instrumentat e vlerësimit të organizimit dhe administrimit strategjik të territorit.
- Instrumentat ekonomik për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit.
- Teoritë emergjente sociologjike: globalizimi, institucionet dhe programet e bashkëpunimit për zhvillim.
- Proceset e organizimit kompleks dhe procesi i optimizimit të vendimmarrjes.
- Manaxhimi strategjik i burimeve njerëzore.
- Metodot dhe teknikat e kërkimit sociologjik.
- Zbatimi i programeve të zhvillimit. etj.

2000

Diploma: Administrator Biznesi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Administrim Biznesi,  
Tiranë (Shqipëri)

2012

Diploma: *Gjuhë - Letërsi*

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Tiranë (Shqipëri)

## Referime dhe botime:

1. *Emigracioni i Shqiptarëve në Itali gjatë periudhës postkomuniste, studim, ISBN978-9928-0-790-0, fq.250, Albas, Tiranë 2016.*
2. *Time-trend of the Albanian Migratory Movements, (Revista: Anthropology, USA, 2014 2-3, ISSN:2332-0916*

*Abstract:* Finding a promised land has been a continuous test for human beings. Migratory movements have obviously a time trend, and Albanians have constantly moved westwards, with Americas being the main final destination. The authors describe in the present paper some of the archival details from the Albanian immigration in the United States, exploring the reasons for these human movements, and describing the time trend of the latter. Prior to such movements, Albania has been familiar to other displacements, mainly towards Italy, a phenomenon of centuries before that recently saw a reactivation, obviously related to economic grounds.

3. *Politika e Italisë ndaj qeverisë së Princ Wied-it, kumtesë e mbajtur në konferencën e Shkollës Doktorale të Departamentit të Historisë (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - UT), 11.03.2014*

Në këtë kumtesë hidhet dritë mbi politikën e Italisë ndaj qeverisë së Princ Wiedit në Shqipëri, vështruar përmes dokumenteve britanike të kohës, të cilat janë përfshirë edhe në një botim të përkthyer në shqip me 4 vëllime (2012). Burimet britanike kanë rëndësinë dhe vlerën e tyre të madhe për t'u konsideruar, jo vetëm sepse sjellin rolin e një vendi të rëndësishëm si Anglia, në hartimin e politikave për Shqipërinë e sapo dalë si shtet më vete, por sepse përmes tyre, arrihet të vlerësohen edhe qëndrimet e shteteve të tjera, siç ishte në ato momente mjaft aktive Italia, me një raport specifik me fqinjin e vet, Shqipërinë, me të cilin e ndanin ujrat e Adriatikut dhe e bashkonin mjaft lidhje e interesa historike dhe aktuale.

4. *Michele Marchiano dhe De Rada, Konferencë shkencore e Fakultetit HF (UT) dhe Bibliotekës Kombëtare, 16.12.2014*

Kumtesa ndalet tek interpretimi që ky studiues arbëresh i ka bërë veprës së De Radës, nga të parët që ka hedhur dritë mbi të dhe bashkëkohës i poetit. Duke qënë hetime mbresëlënëse - nga ato të prekjes prej dorës së pare - ndërkaq ato kanë dhe subjektivitetin e kontradiktat e tyre, që kanë qënë pjesë e debatit në kohët e mëpasme. Veprën e tij *Shqipëria dhe vepra e De Radës* e vlerëson edhe Arshi Pipa, por vë në dukje se, më së shumti, studiuesi arbëresh vlerëson vlerat patriotike sesa ato estetike. Ky qëndrim bëri që ai të ishte disi i rezervuar për poemën *Milosao*, tek e cila, gabimisht shihte më shumë fragmentarizëm e jo aq substancë patriotizmi.

5. *Koncepte historishkruese tek Letratyra shqype e at Justin Rrotës, konferencë shkencore në Universitetin e Shkodrës, 19.12. 2014*

Justin Rrota mbetet pa mëdyshje ndër personalitetet më të kompletuara të dijes shqiptare. Studiues tejet skrupuloz dhe me akribi të lartë shkencore, ai pa mëdyshje, zë vend të merituar në rrethin më të ngushtë të trashëgimisë albaniste, si dijetari që ka sjellë kontribute mjaft të

rëndësishme në fushë të: tekstologjisë - me një varg studimesh rreth veprave të autorëve të vjetër, po kështu në fushë të leksikologjisë, të morfologjisë, fonologjisë, etimologjisë dhe të didaktikës shkollore.

Në këtë kumtesë, ndalemi posaçërisht tek vlerat që përcjell libri për shkollat e mesme *LETRATYRA SHQYPE*, i botuar në Shkodër nga Shtypshkronja Françeskane, më 1925.

Duhet kujtuar se ky është prej librave të parë që kishte për destinacion përcjelljen e letërsisë shqipe në nivelin e shkollave të mesme e kjo nismë do të shoqërohej sigurisht me një varg vështirësish. Vështirësia e parë vinte prej mungesës së traditës në botimet shqiptare të profilit didaktik, të cilat, jo vetëm ishin shumë të pakta në numër, por ishin shpesh edhe të hartuara në mënyrë të improvizuar dhe pa kompetencën e duhur, e krijuar kjo situatë prej kërkesave të ngutshme të shkollave shqipe të sapo çelura - kryesisht pas shpalljes së pavarësisë së vendit. Autori e njih disavantazhin që i silllej prej mungesë së traditës në botimin e teksteve shkollore, ashtu sikundër ka pasur mirë parasysh dhe vështirësi të tjera, sidomos ato, që kishin të bënin me qarkullimin e kufizuar të botimeve letrare të kohës, me gjendjen e fondeve arkivore e bibliotekare të pastabilizuara në nivel institucional, si dhe me egzistencën e një kritike letrare në faza fillestare dhe pa njohje e ndonjë ndikim në rrethet e lexuesve.

6. *Trashëgimia kulturore shqiptare dhe probleme të njohjes së saj në botë*. Seminari VIII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 25-26/ 09.2014

Në këtë referim fokusohet mbi probleme që kanë të bëjnë më impenjimin e institucioneve përgjegjëse për të promovuar vlerat kulturore shqiptare në rajone e evente të ndryshme të botës. Këtu merr rolin e vet edhe legjislacioni egzistues, në qarkullimin e këtyre vlerave, që mbetet ende inefiçent, e shpesh ushqen pengesa të burokracisë së instancave, duke sjellë e gjeneruar kështu shpesh bllokime e vonesa komunikimi.

7. *Interpretimi i kodeve universale përmes procesit përkthimor* (bashkëautor), Seminari XXXIII Ndërkombëtar i Prishtinës për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 30.08.2014

Këtu vihet theksi mbi rolin delikat që luan procesi përkthimor në përcjelljen dhe interpretimin e kodeve universale njerëzore. Përkthimi i veprave prej kohëve të largëta nuk bëhet/vjen si shkak i vjetërimit të leksikut dhe koloritit ambiental, por i kushtëzuar prej kërkesave të kohës që vjen. Mesazhet universale, pra, ato shenja që qarkullojnë nëpër kohë, bëhen natyrshëm referenca - edhe për kohët e pritshme dhe ky mbetet atributi/misioni i përkthimit.

## GJUHËT E HUAJA

	TE KUPTUARIT		TE SHPREHURIT		TË SHKRUARIT
	Degjimi	Leximi	Te kuptuarit	E Folura	
English	C1	C1	C1	C2	C2
Italian	C1	C1	C1	C1	C1
French	B2	B2	B2	B2	B2
Spanish	B1	B1	A2	A2	A2

## AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

- 24 – 26 Nëntor 2004* Përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare në mbledhjen e radhës të Komisionit për Barazi mes Burrave dhe Grave në Këshillin e Europës, Strasburg, Francë.
- 06-09 Dhjetor 2004* Konferenca Ndërkombëtare mbi Luftën Kundër Dhunës Patriarkale ndaj Grave - organizuar nga Ministria suedeze e Punëve të Brendëshme dhe ajo e Punëve të Jashtme. Stokholm, Suedi.
- 14 – 15 Dhjetor 2004* Anëtare e Delegacionit të Qeverisë Shqiptare në Takimin Rajonal Parapërgatitor Beijing +10, Gjenevë, Zvicër.
- 01 Tetor 2004 – 20 Dhjetor 2004* Lektore në një cikël seminaresh, organizuar nga Fondacioni i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Popullsisë.

## EKSPERIENCA PUNE

- 01 Gusht 1999 – 10 Maj 2003* **Menaxhere për Projektet e financuara nga Komisioni European**  
Fondi i Zhvillimit Shqiptar, Tiranë (Shqipëri)
- 15 Shtator 2004 – 30 Prill 2005* **Këshilltare e Kryetares së Komitetit për Mundësi të Barabarta.**  
Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale – Komiteti për Mundësi të Barabarta, Tiranë (Shqipëri)
- 01 Maj 2005 – 30 Shtator 2006* **Menaxhere Programi – PMU LCDP**  
Program Management Unit for Local Development Programs – Projekti i Komisionit European CARDS (Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilization), Tiranë (Shqipëri)
- 01 Maj 2004 – 30 Gusht 2004* **Këshilltare**  
ARPA – Agjencia Rajonale për Mbrojtjen Ambientale, Palmanova, Udine (Itali)

*01 Nëntor 2013 - 01.11.2015* **Këshilltare për Projektet**  
Administrata Doganore Shqiptare